

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, anëtare e trupit gjykues për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, z. Kujtim Luli, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë, duke parashtruar arsyetimin tim në pakicë lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit si vijon:

1. Lidhur me deklarin e likuiditeteve

1.1. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 i Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016 dhe formulari i deklaramit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarin saktë dhe mjaftueshëm të “pasurisë” së tij ku përfshihen edhe likuiditetet, edhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e tyre.

1.2. Likuiditetet, në kuptim të ligjit, janë pasuri për të cilat subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin t’i deklaronte sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, sipas të cilit subjektet [...]detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...]d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

1.3. Subjekti, në asnjë nga deklaratat periodike/vjetore (DPV), nuk ka deklaruar likuiditetet dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e këtyre likuiditeteve.

1.4. Në përgjigje të sa ILDKPKI-ja, referuar deklarimeve lidhur me shkollimin e fëmijëve, i ka kërkuar subjektin të shpjegojë burimet për likuidimin e këtyre vlerave dhe paraqitjen e dokumentacionit, subjekti në shpjegimet e datës 28.3.2016 në ILDKPKI ka depozituar:

- vërtetimin nr.*** prot., datë 13 mars 2009, të “Bankës Kombëtare Tregtare” për gjendje në vlerën 15.000 USD në llogarinë numër ***, hapur në mars 2009 në emër të subjektit;

- vërtetimin datë 24 qershor 2009 të “Intesa Sanpaolo Bank” për gjendjen me vlerë 24.661 USD, në emrin e bashkëshortes F. L. dhe të djalit K. .

duke deklaruar se: “Burimi i këtyre dy depozitave bankare kanë qenë kursimet e deklaruara në vitin 2003 dhe një pjesë e kursimeve vit pas viti të të ardhura të mia dhe të bashkëshortes të deklaruara në vitet 2003-2013 minus shpenzimet e deklaruara”.

1.5. Në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2003, njëkohësisht edhe në deklaratën për herë të parë, subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar gjendje cash dhe, në vijim, nuk kanë deklaruar pakësim të saj në deklaratat e interesave private, ndaj gjendja cash, e cila nuk është deklaruar si pakësim, nuk mund të ketë mbuluar depozitimin e këtyre likuiditeteve pretenduar nga vetë subjekti në sqarimet e dhëna me shkrim prej tij në datën 28.3.2016, në ILDKPKI.

1.6. Referuar transfertave bankare të kryera në llogarinë e tij në “Bankën Kombëtare Tregtare”, subjekti ka kryer depozitime nga viti 2009 deri vitin 2014 në vlerën totale prej 103.856 USD.

1.7. Referuar vërtetimit datë 24 qershor 2009, bashkëshortja dhe djali kanë pasur gjendje me vlerë 24.661 USD në llogarinë e tyre në “Intesa Sanpaolo Bank”.

1.8. Fakti që vlerat prej 103.856 USD në llogarinë e subjektit në “Bankën Kombëtare Tregtare” dhe vlera 24.661 USD në llogarinë e bashkëshortes dhe djalit në “Intesa Sanpaolo Bank” janë të verifikueshme në bankë, nuk legjitimon burimin e të ardhurave për këto depozitime, të cilat kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve.

1.9. Në konkluzion, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka mosdeklarim të likuiditeteve dhe mungesë të mjeteve financiare për krijimin e tyre.

2. Lidhur me deklarimin e shpenzimeve

2.1. Dispozitat ligjore që rregullojnë vlerën e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit janë neni Ç, pika 4 dhe neni D i Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

2.2. Subjekti në asnjë nga deklaratat periodike/vjetore (DPV), dhe as në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, nuk ka deklaruar dhe përfshirë në llogaritje, shpenzime jetese dhe udhëtimi për djemtë e tij referuar viteve të studimit.

2.3. Deklarimi gjatë hetimit administrativ i shpenzimeve të jetesës së djalit K.L. në “W. P. I.” në vlerën 187.960 lekë për vitin 2009; në vlerën 419.800 lekë për vitin 2010; në vlerën 353.069 lekë në vitin 2011; dhe në vlerën 358.075 lekë në vitin 2012, nuk mbështetet nga të dhënat e universitetit në faqen zyrtare¹ të tij.

2.4. Sipas të dhënave të universitetit, një student me kohë të plotë, nga shtatori në qershor, referuar fillimit të studimit të djalit K. L., paguan 13.360 USD detajuar si vijon:

për libra:	1.000 USD;
për dhomë:	6.530 USD;
për ushqim:	4.630 USD;
për shpenzime të tjera:	1.200 USD.

2.5. Deklarimi i subjektit gjatë procesit administrativ i shpenzimeve të udhëtimit në vitin 2010 në vlerën 350.134 lekë; në vitin 2011 në vlerën 317.745 lekë; dhe në vitin 2012 në vlerën 141.439 lekë, vjen në kundërshtim me deklaratimet e vetë subjektit në datën 28.3.2016 në ILDKPKI, ku ai ka deklaruar vlerat 400.000 lekë/vit, si shpenzime të udhëtimit në këto vite.

2.6. Në konkluzion, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë shpenzimet e shkollimit gjatë viteve dhe në deklaratën “Vetting”, pasi nuk ka deklaruar dhe përfshirë në llogaritje, shpenzime jetese dhe udhëtimi, për djemtë e tij referuar viteve të studimit, dhe deklaratimet gjatë hetimit për to ishin të pasakta si më sipër arsyetuar, ndaj subjekti ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

3. Lidhur me analizën financiare

3.1. Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

3.2. Të ardhurat e djalit K. L. nga puna në shkollën “W. P. I.”, M., Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 2012, në shumën 7.110 USD, deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, nuk rezultojnë të jenë deklaruar në deklaratën e interesave private në vitin 2012.

3.3. Të ardhurat e djalit K. L. nga puna në shkollën “W. P. I.”, në vitin 2010-2011 nuk rezultojnë të jenë deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, dhe as në deklaratat e interesave private të vitit 2010-2011.

www.wpi.edu/sites/default/files/docs/Offices/Institutional-Research/WPI_CDS_2009-2010.pdf

3.4. Përfshirja e të ardhurave nga puna e djalit K. në analizën financiare në vitet 2010 në vlerën 90.887 lekë; në vitin 2011 në vlerën 334 575887 lekë; dhe në vitin 2012 në vlerën 917.781887 lekë, është e pambështetur ne prova për sa deklaratat periodike vjetore të subjektit kanë vlerën e provës, referuar pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të nenit 11 të Kodit të Procedurave Civile.

3.5. Lidhur me të ardhura nga konsulenca juridike e bashkëshortes për shoqërinë “P***o” sh.p.k. në vitin 2009 në vlerën 500.000 lekë; në vitin 2011 në vlerën 500.000 lekë; dhe në vitin 2012 në vlerën 500.000 lekë, nuk mbështeten në prova, nuk ka vërtetim të lëshuar nga tatimet me emërtimin konfirmim për pagesë të tatimit në emër të individit F. L., dhe:

(i) Referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit shoqëria “P***o” sh.p.k. ka deklaruar humbje: për vitin 2009 në vlerën 2.253.111 lekë; për vitin 2011 në vlerën 1.014.222 lekë; për vitin 2012 nuk ka deklaruar të ardhura dhe shpenzime.

(ii) Prova e sjellë nga subjekti – shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës për subjektin “P***o” sh.p.k., konfirmon vlerën totale për tatimin në burim në shumën 312.944, për periudhë 15-vjeçare, nga momenti i krijimit të kësaj shoqërie, prej datës 25.5.1999 deri më 31.12.2014 lekë, duke mos provuar se pagimi i tatimit në burim ka qenë për 2009, 2011, 2012.

3.6. Lidhur me të ardhura nga konsulenca juridike e bashkëshortes për shoqërinë “P***i” sh.p.k. në vitin 2009 në vlerën 400.000 lekë, nuk ka vërtetim të lëshuar nga tatimet, me emërtimin konfirmim për pagesë të tatimit në emër të individit F. L., si dhe:

(i) Prova e sjella nga subjekti shkresë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për subjektin “P***i” sh.p.k.e cila konfirmon pagesat në datë 3.4.2009 në shumën 33.796 lekë, nuk përkon me kohën e referuar të ofrimit të shërbimit për gjithë vitin dhe as me vlerën e përfituar nga bashkëshortja nga kjo shoqëri për të cilën duhej paguar vlerë tjetër tatimi në burim.

(ii) Prova e sjellë nga subjekti – shkresë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për subjektin “P***i” sh.p.k., e cila konfirmon pagesë tatimi në burim shumën 33.796 lekë, në datën 3.4.2009, duke mbajtur në konsideratë faktin se diferenca e tatimeve, si diferencë e detyrimeve, në varësi të volumit të të ardhurave, saktësohet dhe paguhet si detyrim, pasi subjekti tatimor paraqet dhe depoziton pasqyrat financiare të vitit ushtrimor – brenda 3 muajve të parë të vitit pasardhës (deri më 31 mars), nuk provon vitin ushtrimor tatimor për të cilin është paguar ky tatim nga shoqëria “P***i” sh.p.k.

3.7. Në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të ardhurat e bashkëshortes, të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative dy kriteret ligjore, janë deklaruar dhe për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi, janë të ardhurat nga konsulencë juridike “A. K.” sh.p.k. 500.000 lekë në vitin 2009, të ardhurat nga konsulencë juridike “A. K.” sh.p.k. 500.000 lekë në vitin 2011 dhe të ardhurat e konfirmuara nga verifikimi në sistemin C@TS, fitimi neto 210.284 lekë në vitin 2012.

3.8. Për sa më sipër, analiza financiare e kryer për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit dhe të personave të lidhur me të, duhej bërë duke mos përfshirë të ardhurat e djalit K. L. nga puna në Shkollën e Lartë në vitet 2010- 2012 dhe duke përfshirë të ardhurat e bashkëshortes në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

3.9. Nga vlerësimi i të dhënave në gjendjen që janë aktet, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet, duke rezultuar me balancë negative për vitin 2009 në vlerën - 1 435 601 lekë, viti 2011 në vlerën - 1 433 810 lekë dhe viti 2012 në vlerën - 1 688 909 lekë në vlerë totale balance negative prej - 4.558.320 lekësh.

3.10. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për rrjedhojë, ndodhen në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera për vitet 2009-2012 në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

4. Lidhur me vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve të procesit të rivlerësimit

4.1. Për pasurinë “apartament”, me sipërfaqe 105.1 m², në rrugën “F.R.”, Tiranë, burimi i krijimit, kredia me kushte lehtësuese për strehim në “Bankën e Kursimeve” në shumën 5.000.000 lekë, u përfitua bazuar në VKM - në nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

4.2. Referuar VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, përfitimi për kreditimin në vlerën 5.000.000 lekë ishte kur subjekti nuk kishte në pronësi pasuri të paluajtshme / ndërsa përfitimi për kreditimin në vlerën 2.500.000 lekë ishte kur subjekti nuk kishte sipërfaqe të mjaftueshme banimi.

4.3. Në këtë logjikë, blerja e banesës në rrugën “F. R.”, Tiranë, u krye kur, referuar hetimit, subjekti kishte në pronësi një banesë, me sipërfaqe 55.9 m², në rrugën “Q.S.”, p***, shk. ***, ap. ***, Tiranë (e cila referuar VKM-së nr. 113, datë 20.1.1997, ishte brenda normës për strehim për familje me 4 anëtarë) dhe gjendje *cash* në vlerën prej 3.000.000 lekësh.

4.4. Referuar sa më sipër, subjekti ka përfituar prej kësaj kredie të butë, në mospërmbushje të asnjë prej kritereve ligjore, të VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, duke vepruar në keqbesim dhe në kundërshtim të kritereve të zbatueshme në përfitimin e këtyre kredive.

4.5. Duke pasur parasysh nga njëra anë se subjekti i rivlerësimit, ka përfituar prej kësaj kredie të butë për të shtuar pasuritë e tij, nga ana tjetër qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve që, ndër të tjera, është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, çmoj se kjo sjellje përbën shkelje etike të figurës së prokurorit dhe shërben për vlerësimin e përgjithshëm në drejtim të cënimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

5. Në përfundim, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet gjatë periudhës 2009 - 2012, duke rezultuar me një diferencë negative në total prej - 4.558.320 lekësh, referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3, si dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ndodhet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë, lidhur me likuiditetet dhe shpenzimet.

6. Në përfundim, për vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve të procesit të rivlerësimit, çmoj se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

7. Për sa më sipër argumentuar, kam votuar kundër konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kujtim Luli, duke vlerësuar se ndaj tij duhet të ishte zbatuar masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, mbështetur në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Xhensila PINE

Anëtare/ në pakicë